

VENDIM
Nr. 10, datë 3.4.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.1.2018 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 68/10 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Liman Laçi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, Prefekti i Qarkut Dibër
Bashkia Klos

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajftueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2017-143, datë 21.3.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/“F” dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe prefektit të Qarkut Dibër, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me aktin e marrjes në pronësi nr. 74, datë 20.1.1994 kërkuarit i është dhënë në pronësi një sipërfaqe toke prej 10.400 m² tokë arë, në emër të familjes bujqësore të kërkuarit, Liman Laçi, në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”.

2. Prefekti i Qarkut Dibër, bazuar në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të titullit të marrjes së tokës në pronësi, pasi ka rezultuar se kërkuari nuk ka qenë banor i fshatit Suç në datën 1.8.1991, kur ka filluar efektet ligji nr. 7501/1991.

3. Komisioni i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, me vendimin nr. 46, datë 8.11.2010, ka vendosur: “*Pavlefshmërinë ligjore dhe shfuqizimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të kërkuarit.*”.

4. Për konstatimin gjyqësor të këtij vendimi, prefekti i Qarkut Dibër i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e ATMP-së së kërkuarit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 298, datë 4.10.2011, ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë së prefektit të Qarkut Dibër.*”.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1083, datë 8.5.2012 ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit.*”.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-143, datë 21.3.2017, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimeve të të dyja gjykatave. Pranimin e padisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të marrjes*

së tokës në pronësi.”.

II

7. **Kërkuesi** është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ, duke pretenduar se ai është i padrejtë dhe antikushtetues, pasi ka cenuar të drejtën e pronësisë nëpërmjet një procesi të parregullt ligjor. Pavarësisht se ai *de jure* nuk rezulton i regjistruar në gjendjen civile të njësisë Klos në datën e hyrjes në fuqi të ligjit “Për tokën”, *de facto* ai nuk është larguar asnjëherë nga fshati dhe nuk ka pasur asnjë vendbanim tjetër jashtë tij. Vetëm fakti i lëvizjes formale të vendbanimit nuk mund t’i heqë të drejtën e pronësisë mbi tokën, të cilën ai e ka fituar sipas ligjit, pasi ka qenë prej shumë vitesh banor i atij fshati.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit**, ka parashtruar se procesi i zhvilluar para Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është bërë në përputhje me rregullat procedurale dhe materiale të parashikuara për këtë qëllim. Kërkuesi nuk ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, por vetëm ligjore, të cilat nuk janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

9. **Subjekti i interesuar, prefekti i Qarkut Dibër**, ka parashtruar se pretendimet e kërkuesit nuk qëndrojnë. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i mbështetur tërësisht në ligj e prova dhe, si rrjedhojë, ka respektuar të gjitha elementet e procesit të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/1/“f” dhe 134/1/“i” të Kushtetutës. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 21.3.2017, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 18.7.2017, pra brenda afatit 4-mujor, sipas nenit 71/“a”, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/1/“f” të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Rezulton se kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet dhe legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate për sa pretendon në kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës

12. Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Administrativ është antikushtetues, pasi ai ka cenuar të drejtën e pronës nëpërmjet një procesi të parregullt. Ai kolegji ka interpretuar provat dhe faktet në mënyrë të ndryshme nga dy gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm, gjë që nuk përputhet me natyrën e gjykimit të Gjykatës së Lartë.

13. Në jurisprudencë të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën

rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Referuar çështjes konkrete për gjykim, Gjykata sjell në vëmendje se ajo ka marrë më parë në shqyrtim ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”* dhe ka çmuar: *“Ky ligj është në pajtim me Kushtetutën vetëm nëse ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e theksuara prej kësaj Gjykate. Konkretisht, ai nuk prek titujt e pronësisë të dhënë në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tyre, pasi komisionet vendore janë vetëm konstatuese të pavlefshmërisë, ato nuk mund të anulojnë apo shfuqizojnë tituj të pronësisë apo të urdhërojnë regjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme. Është vetëm gjykata, e cila mbi padinë e të interesuarve apo autoriteteve publike përkatëse, vendos përfundimisht në lidhje me të drejtën e pronësisë së subjekteve të interesuara [...] sipas nenit 10/1 të këtij ligji, kur KV-ja, gjatë verifikimit, vëren se krijimi i titujve të pronësisë mbi tokën është bërë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, i paraqet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ “akti i marrjes së tokës në pronësi”, dhe sipas pikës 2, të nenit 10 të këtij ligji, kërkesa i paraqitet subjektit përkatës nga prefekti dhe objekti i kërkesës së prefektit është deklarimi i pavlefshmërisë së “aktit të marrjes së tokës në pronësi”* (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata thekson se qëllimi i ligjit nr. 9948/2008 është verifikimi i titujve të pronësisë së tokave bujqësore për ligjshmërinë e tyre, në mënyrë që të shmanget marrja e pronësisë së tokës bujqësore në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 7501/1991, *“Për tokën”* dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Në ligj është parashikuar shprehimisht se kur AMTP-ja e përfituesit të tokës bujqësore shfuqizohet me vendim të gjykatës, prona e përfituar padrejtësisht duhet të kalojë në pronësi të shtetit dhe jo të mbetet në pronësi të personave të tretë.

16. Në çështjen konkrete rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë marrë në shqyrtim kërkesëpadinë e prefektit të Qarkut Dibër dhe kanë arritur në përfundimin se shkella e pretenduar prej paditësit (pra, mosqenia i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile të fshatit Suç në datën 1.8.1991) nuk është e tillë që ta bëjë absolutisht të pavlefshëm titullin e pronësisë. Të dyja gjykatat e kanë pranuar faktin se kërkuksi ka bërë transferimin e gjendjes civile dhe bashkë me të edhe të lejes së banimit në datën 7.7.1991 nga fshati Suç në qytetin Klos, pra vetëm disa javë para datës që përcakton ligji nr. 7501/1991 si afat përfundimtar për përfitimin e tokës si pjesë e familjes bujqësore, por *de facto* kërkuksi dhe familja e tij kanë vazhduar të jetojnë në fshatin Suç, gjë që provohet edhe nga fakti se fëmijët e tij kanë frekuentuar shkollën e fshatit Suç. Në këtë këndvështrim, gjykatat kanë konstatuar se ky fakt nuk është i tillë që ta bëjë AMTP-në e përfituar nga kërkuksi një akt absolutisht të pavlefshëm, pasi qëllimi i ligjit nr. 7501/1991 për t'i dhënë një anëtar të familjes bujqësore tokë rezulton i realizuar. Kërkuksi ka qenë vazhdimisht dhe pa ndërprerje banor i fshatit Suç, gjë që është vërtetuar gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel.

17. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të bëjë vlerësim të ndryshëm për të njëjtat fakte nga ato që kanë bërë dy gjykatat më të ulëta, pasi kjo gjë nuk është në përputhje me juridiksionin e asaj gjykate. Gjykata është shprehur se nxjerrja e një konkluzioni të kundërt nga ana e Gjykatës së Lartë, lidhur me provat e marra gjatë gjykimit në dy gjykatat e shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit të saj. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse ajo vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo nëse çmon se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët

më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 44, datë 19.7.2016; nr. 7, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Kolegji i Gjykatës së Lartë nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt (*shih vendimet nr. 83, datë 30.12.2015 dhe nr. 20, datë 20.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji Administrativ në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të zhvilluar në vazhdimësi nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj (*shih vendimet nr. 36, datë 30.6.2014; nr. 87, datë 30.12.2016 dhe nr. 56, datë 25.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/“P” dhe 134/1/“I” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-143, datë 21.3.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo